



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Sesioni V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, 21.09.2015. në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Mungon: Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi dhe Senad Karaahmetović përfaqësues të OSBE-së , gazetarë e programit në gjuhën serbe të RTK-së Melina Muric, gazetarë e RTK-së Albana Bajrami, gazetar nga Kosova Pres- Ismail Shabani, përfaqësues i KAAD Artan Murati, përfaqësues i Sekretariatit të KVZ - Zijush Ahmeti- dhe përfaqësues për media i Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Koordinator - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore - Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 28.07.2015;**
- 3. Revidetimi i Planit të Punës për vitin 2015;**
- 4. Shqyrtimi i situatës lidhur me rektoratin;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.07.2015.

Kryesuesja – konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së dat. 28.07.2015, pa vërejtje.

3. Revidetntimi i Planit të Punës për vitin 2015;

Kryesuesja – theksoi se Komisioni ka vullnet të mirë në realizimin e aktiviteteve në bazë të Planit të Punës, për vitin 2015.

Sa i përket monitorimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjit për Hoç të Madhe, grupi punues ka arritur në kontinuitet të kryej aktivitetet e saja. GP në bashkëpunim me stafin e komisionit është në përfundim të hartimit të raporteve dhe në periudhë sa më të afërt të njejtat do të shqyrtohen në Komision, më pas do të prodhohen raportet preliminare për miratim në Kuvend.

Shfrytëzojë rastin të ftojë të gjithë anëtarët e grupeve punuese të cilat janë në procedurë të monitorimit të Ligjit për Shërbyes Civil dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, që aktivitetet të realizohen në të gjitha fazat dhe të ken bashkëpunim me faktorët relevant. Kërkesa e saj ishte që GP paraprakisht të raportojnë komisionin për procedurat e arritura dhe në fund të vitit komisioni të dal me raporte preliminare në Kuvend.

Pasi nuk kishte propozime tjera nga anëtarët e komisiopnit për plotësim dhe ndryshim të Planit të Punës për vitin 2015, kryesuesja propozoi të kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i situatës lidhur me rektoratin;

Kryesuesja- tha se kjo çështje është inicuar me kërkes të disa anëtarëve të komisionit lidhur me situatën e krijuar në Rektoratin e Univerzitetit të Prishtinës me qëllim që të shqyrtohet mundësia e publikimit të konkursit të dytë për vendet e paplotësuara të konkursit të parë për studentët e komunitetit jo shumicë, në vitintin akademik 2015/2016 .

Në fjalën e saj tha se në sistemin arsimor, si autoiritet kryesor është ministri i MASHT-it dhe Rektori i UP-së, të cilët janë përgjegjës në zabueshmërin e ligjislacionit dhe respektimin e të drejtave të komunitetit jo shumicë.

Kryesuesja, hapi debat me qëllim që anëtarët e Komisionit të ofrojnë opinionet e tyre.

Danush Ademi – shpreh qëndrimin e tij se me vite përsëriten problemet e njejtat nga ana Rektoratit të Univerzitetit të Prishtinës dhe MASHT-it, kur bëhet fjalë për shpallje të konkursit për regjistrim të kandidatëve të komunitetit jo shumicë . Për këtë vit, rektorati i UP-së ka parapar regjistrimin e 328 studentëve të komunitetin jo shumicë, mirëpo janë bër keqpërdorime dhe kan mbetur të paregjistruar një numër i konsiderueshëm i studentëve të komunitetit jo shumicë.

Diskutoi lidhur me publikimin e testit, ku të drejtë pranimi për regjistrim të studentëve në afat të parë kanë kandidatët të cilët arrijnë kuotën 40%, nga numri i pikëve të parapara për provim pranues. Në kuadër të informatave që ka, UP-së nuk do përsëritë konkursin për regjistrim të kandidatëve të cilët nuk arrijnë kuatën e përcaktuar edhe nëse mbeten vendet e lira. Ai konsideron se ekziston lista e kandidatëve të komunitetit jo shumicë të cilët e kan arritur kuotën e kalueshmëris dhe të njejtit nuk janë pranuar.

Në bazë të vendimit të UP-së, do të realizohet shpallja e konkursit plotësues për regjistrim të studentëve nga lugina e Preshevës, Medvegjës, Bujanovcit, të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Maqedonisë ndërsa nuk parasheh shpalljen e konkursit për studentë e komunitetit Boshnjak, Turk, Romë, Ashkali, Egjiptian dhe Kroat. Konstaton se për situatën e krijuar, përgjegjësia bie në MASHT dhe Univerzitetin e Prishtinës ' Hasan Prishtina'.

Si problem tjetër është çështja e vendeve të rezervuara, me çrast qytetarët kosovar arrijnë të marrin vërtetime falso, kinse i përkasin komunitetit pakic, vetëm për të zënë vendet në Univerzitete. Ky fakt dëshmon se ka keqpërdorime nga se nuk respektohen të drejtat e komunitetit pakic.

Theskoj se komuniteti i tij ka interesim të shkollohet, ndërsa kjo e drejtë iu është cenuar me faktin se të drejtë zgjedhore kanë vetëm në lëmin e bujqësis dhe atë teknik, ndërsa iu mohohet mundësia në drejtim të mjekësis dhe ekonomisë. Është për keqardhe që çështja në fjalë ka mbetur në kompetencë të kryetarëve të komunave të cilën drejtë veprimi ua japin drejtorëve të komunave. Kërkesa e tij ishte që veprimet e tilla të parandalohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen.

Ai propozoi që Komisioni të bëjë thirrje urgjente rektorit të Univerzitetit të Prishtinës, me qëllim të marrjes së informatave të nevojshme për shpalljen e konkursit plotësues, për kandidatët e komunitetit jo shumicë.

Qerim Bajrami – theksoi se këtë çështje e ka ngritur më herët në Kuvend, duke iu referuar kryeministrit z. Isa Mustafa për të ndikuar në MASHT dhe Rektoratin e Univerzitetit të Prishtinës, të krijohen kushtet e shpalljes së konkursit për regjistrimin e studentëve të komunitetit jo shumicë, në nivel të parë të studimeve, në vitin akademik 2015/16.

Ai foli për kriteret e shpalljes së konkursit të UP-së, ku të drejtë pranimi kanë kandidatët të cilët arrijnë kuotën 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues. Në nivelin e parë akademik 2015, prej 328 kandidatëve të komunitetit jo shumicë kanë mbetur të pa regjistruar 300 student. Sipas mendimit të tij është i papranueshëm deklarimi i UP-së, se student kanë qenë teknikisht të pa pregaditur për arritjen e pragut të kalueshmëris. Konsideron se pengesë kryesore ka qenë mos njohja e gjuhës shqipe dhe mos informimi me kohë për këtë kategori të kandidatëve.

Me iniciativë të disa anëtarëve të GP 6+, në muajin maj të këtij viti, kemi takuar përfaqësues të kabinetit të MASHT-it, një ndër kërkesat tona ka qenë shtypja e testeve në gjuhë të kandidatëve të komunitetin jo shumicë, për regjistrim në universitete. Mirëpo, MASHT-i deri më sot nuk iu është përmabtur premtim të dhën dhe kjo problematik paraqet pengesë të madhe për shkollimin e komunitetit tan.

Ajo çka e shqetëson më së shumti është fakti se Univerziteti i Prishtinës planifikon shpalljen e konkursit plotësues vetëm për pjesëtarë e luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi ndërsa nuk parasheh shpalljen e konkursit për kandidatët e komunitetit jo shumicë. Konsideronë se mos publikimi i konkursit plotësues, paraqet shkelje të rëndë për këtë kategori të komuniteteve.

Ne jemi të interesuar që nxënësit tan të mos mbetesin vetëm me shkollim të mesëm por të mundësohet regjistrimi në fakultete dhe më pas të inkuadrohen në institucionet e Republikës së Kosovës.

Njëherit pajtohet me propozimin e deputetit Ademi, që në takim të komisioni të ftohet rektori i UP-së, lidhur me sqarimet për shpalljen e konkursit të tretë, për kandidatë të komunitetit jo shumicë.

Mufera Sinik – shpreh pakënaqësin e saj lidhur me zhvillimet e shpalljes së konkursit për afat të parë, të vitit akademik 2015/16, nga ana e Rektoratit të Univerzitetit të Prishtinës.

Theksoi se gjuha turke, boshnjake dhe rome janë gjuhë zrtare të garantuara me Kushtetutë. Qytetarët e komunitetit turk nuk kanë njohuri të duhur të gjuhës shqipe dhe mos shtypja e testeve në gjuhën e komuniteteve paraqet penges në plotësimin e pikëve të parapara për provim pranues. Në kuadër të ndjekjes mësimore në gjuhë turke dhe boshnjake në qytetin e Prizrenit, nxënësit nuk marrin diploma në gjuhën e tyre por certifikata. Kërkesa e saj ishte që të arrihet një zgjidhje e përhershme për këtë kategori të qytetarëve.

I njoftoi anëtarët e komisionit se për ditën e nesërme, komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji ka ftuar në takim ministrin z. Arsim Bajrami që të informoj lidhur me procedurat e shpalljes së konkursit plotësues për kandidatët e komunitetit jo shumicë . Ajo propozoi që të mbahet takimi i përbashkët të dy komisioneve, me qëllim të paraqitjes së kërkesave tona, dhe më pas komisioni do të dal me rekomandime konkrete.

Pajtohet edhe me propozimin e deputetit z. Ademi, që komisioni të takoj rektorin e Univerzitetit të Prishtinës, lidhur me gjetjen e mundësis për shpalljen e konkursit plotësues të kandidatëve të komunitetit jo shumicë.

Kryesuesja – u ndërlidh me temën e ngritur nga znj. Myfera, dhe njëherit propozoi që një grup i anëtarëve të komisionit të merr pjesë në komisionin për arsim, shkencë, kulturë, rini dhe sport me qëllim të diskutohet çështja e shpalljes së konkursit të tret për kandidatët e komunitetit jo shumicë. Ajo shtoi se më pas, komisioni do të caktoj një takim edhe me rektorin e UP-së, ku do të rekomandojmë ri- shpalljen e konkursit plotësues, në nivel akademik 2015/16.

Veton Berisha – në fjalën e tij tha se në sistemin arsimor, si autoritet kryesor dhe përgjegjës është ministri i MASHT-it dhe Rektori i Univerzitetit të Prishtinës lidhur me zabueshmërin e ligjislacionit dhe respektimin e të drejtave të komunitetit jo shumicë.

Sa i përket çështjes së edukimit, shkollimit të pjesëtarëve të komunitetit pakicë, të njejtit nuk gëzojnë të drejta të barabarta në krahasim me pjesëtarët e komuniteteve tjera. Mendon se mungojn vlerat demokratike nga se shumë pak është investuar për shkollimin e komunitetit Romë, Egjiptian dhe Ashkali.

Bazuar në shpalljen e konkursit të rregullt nga Univerziteti i Prishtinës, të drejtë pranimi kanë kandidatët të cilët arrijnë kuotën e përcaktuar nga pikët e parapara për provim pranues dhe përkrah këtë vendim. Ajo çka e shqetëson më së shumti është vendimi i UP-së, ku shkruan se me rastin e përmbushjes së numrit të kandidatëve nuk do të shpall konkurs plotësues edhe nëse mbeten vendet e lira për regjistrim të studentëve të komunitetit jo shumicë.

Deklarata e UP-së na ven në lajthitje, nga se një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të komunitetit pakic e kanë arritur kuotën e kalueshmëri dhe të njëjtit nuk janë pranuar.

Ai konstaton se kuota nuk është rregulluar me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës. Me këtë rast propozon që përcaktimi i kuotës të rregullohet me ligj e jo me urdhëresë administrative.

Kërkesa e tij ishte që në afat sa më të afërt, të ftohet në takim ministri i MASHT-it dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës, që të informohemi drejtpërdrejtë për mundësinë e shpalljes së konkursit të tretë, në bazë të vendeve të rezervuara, për komunitetin jo shumicë.

Sasa Milosavljevic – sa i përket sistemit të arsimit, po shihet se problemi është unik në të gjitha Universitetet në Kosovë. Mund të thuhet se ka keqpërdorime dhe nuk respektohen të drejtat dhe interesat e komunitetit pakicë. Lidhur me këtë çështje, ai pajtohet të mbahet takimi i përbashkët i dy komisioneve, me qëllim të arrihet një zgjidhje adekuate.

Agim Kikaj - plotësisht e mbështet shqetësimin e ngritur të anëtarëve të komunitetit. Jemi në dijeni se UP-së i ka të përcaktuara programet e saja për hapjen e konkursit të rregullt, gjithashtu Senati i përcakton kuotat ku të dy palët duhet të respektojnë legjislacionin në fuqi. Mëpo për komision është me rëndësi të kuptohet arsya e mos shpalljes së konkursit të dytë për komunitetin jo shumicë. Si zgjidhje më e mirë është të rekomandohet përsëritja e konkursit plotësues për kandidatët e komuniteteve tjera.

Pas diskutimeve, komisioni për të Drejta, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, nxjerri këtë:

Përfundim

Ngarkohet shërbimi i sekretarisë së komisionit që të dërgojë një kërkesë në MASHT dhe në Rektorat të Universitetit „Hasan Prishtina” me rekomandim për përsëritjen e konkursit për afatin e tretë për regjistrim të studentëve, pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, si mekanizëm i mundshëm për pranimin e kandidatëve në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë në arsimimin superior në nivelin universitar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković